



Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, Fakulteti Juridik

Departamenti: E Drejta Financiare

Tema: *Themelimi dhe rëndësia e Fondeve Pensionale – Analizë Krahasuese e shteteve të Ballkanit Perëndimor*

Mentor: *Prof.Dr. Mejdin Bektashi*

Kandidati: *Besnik Bllacaku*

ABSTRAKT

Koncepti i sistemit pensional është ndërthurur që të lehtësojë mënyrat e kontribuimit dhe përfitimit të të ardhurave nga individët që kualifikohen përmes përcaktimit të ligjeve, ajo është themeluar për plotësimin e nevojave të punëtorëve dhe individëve që kërkojnë asistencë sociale.

Shtetet e Ballkanit Perëndimor specifikisht kanë rregulluar gradualisht sistemet pensionale gjatë një periudhe kohore në mënyrë që modeli i tyre të përkojë me kërkesat e popullsisë, por edhe të jetë në interes të shteteve dhe politikave të tyre fiskale. Fondet Pensionale paraqesin dallimet thelbësore nga mënyra se si përbëhen ato, specifikisht skemat që ofrojnë, mbulimet e të ardhurave, reformat e ndryshme apo edhe mungesa e tyre, mirëqenja, sfidat me të cilat ballafaqohen shtetet e rajonit siq janë: ndryshimet demografike, ekonomia, asetet financiare të qeverive, politikat e tyre ndaj fondit pensional dhe përqindja e forcës, punëtorëve në treg.

Në fushën e sistemit pensional Shtetet e Ballkanit Perëndimor edhe pse kanë dallime nga mënyra se si funksionojnë, shumica nga to përmbajnë modelin e përbërë nga tri shtylla: shtylla e parë apo ajo e detyrueshme, shtylla e dytë, dhe shtylla e tretë apo ajo vullnetare.

Politikat fiskale specifikisht në skemat e fondeve pensionale variojnë, edhe pse ato janë të ngjashme në strukturat e tyre, shembull përbërja e fondeve pensionale nga tri shtylla e modeluar nga Bashkimi Europian, apo ngjashmëritë në formën e funksionimit dhe madje me problemet nga të cilat përballen dhe mund të ndikohet funksionimi i fondit pensional.

Fjalët kyçe: PAY AS YOU GO, BQK (Banka Qendrore e Kosovës), Fondet Pensionale, Trusti.